



## VENDIM

*Nr. 107 Datë 07.11. 2014*

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENSËS SË  
SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SH.A. NË AKTIVITETIN E  
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE  
NR.102, DATË 21.12.2009.**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9 ; 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “P”; 5 pika 1 gërma “P”; 13 ; 14 pika 1 dhe 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës **07.11.2014**, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AXPO ALBANIA” sh.a. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

### **Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “AXPO ALBANIA” sh.a. plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërërisht.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
Bordi i Komisionerëve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për rinovimin e licensës së shoqërisë “AXPO Albania” sh.a. në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.102, datë 21.12.2009.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIM**

*Nr. 107 Datë 07.11. 2014*

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENSËS SË  
SHOQËRISË “AXPO ALBANIA” SH.A. NË AKTIVITETIN E  
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE  
NR.102, DATË 21.12.2009.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundra
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____